



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2024:108768

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06593782

P.nr.64/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJE-DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me bashkëpunëtore Albulena Morina-Lulaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit: L J nga Komuna K rruga , për shkak të veprës penale “ Vjedhja ”, nga neni 313 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), dhe të akuzuarit L Th nga fshati Z Komuna K për shkak të veprës penale “ Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale “ nga neni 333 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.500/2024, të datës 05.04.2024, pas mbajtjes së seancës publike shqyrtimit fillestar me datë 13.11.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit L J dhe L Th, se bashku me mbrojtësin e tij Fatos Hasanaj, ku me datë 13.12.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

L J, i lindur me datë , në fshatin G, Komuna Klinë, tani me banim në Komuna Klinë rruga “ F E, nga babai M dhe nëna Z, e gjinisë G, me numër personal , me gjendje të dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar, baba i fëmijëve, nacionaliteti shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

L TH i lindur me datë , në fshatin Z Komuna K, nga babai H dhe nëna Z, e gjinisë S me numër personal , me gjendje të mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, punëtor në lokalitetin “

Elektro Servis L M ‘’, i martuar, baba i fëmijëve, nacionaliteti shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Për shkak se:

I pandehuri L J i lindur me , rreth orës 14:00, rruga ‘’ S R’ K, pikërisht në firmën ‘’ B E ‘’, me dashje tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete dhe atë të dëmtuarit B D , në atë mënyrë që pasi i pandehuri ishte punëtor në firmën e lartëcekur, shkon në bodrumin e firmës kinse për ta pastruar bodrumin ku i merr paketat në të cilat kishte mjete elektrike, i ngarkon në kamionetën e firmës kinse për t’i dërguar në vendin ku bëhet deponimi i paketave nga kjo firmë, e më pas i merr dy pllakat e shporetit të cilat ishin të vendosura në ato paketa me vlerë nga 300 euro secila , dhe të njëjtat ia shet punëtorit të kësaj firme të pandehurit LThnë vlerë prej 180 euro,

-Me çka ka kryer veprën penale ‘’ Vjedhja ’’, nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

I pandehuri L Th

Me datën 07.04.2024, në kohë të pacaktuar, në fshatin G, pikërisht në deponinë e mbeturinave, me dashje blen sendet të cilat ka mundur ta dijë se janë përfituar me kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që i pandehuri L pasi kontaktohet përmes telefonit nga i pandehuri L, shkon tek deponia e mbeturinave dhe nga i pandehuri L blen dy pllaka shporeti në vlerë prej 180 euro, ani pse kishte vlerë reale shumë më të madhe në treg dhe atë secila pllakë nga 300 euro, i cili më pas i dërgon fillimisht në shtëpinë e të pandehurit L, e më pas nga aty i ngarkon në veturën e tij pick up dhe i dërgon tek lokali i tij në K,

-Me çka ka kryer veprën penale ‘’ Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale ‘’ nga neni 333 par. 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 370 par. 8 lidhur me par.6 dhe par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 369 të KPPRK-së të pandehurit i:

GJYKON
DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME KUSHT

1.Ashtu që të pandehurit L J i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprën tjetër penale.

DËNIM ME GJOBË

Dënim në shumën katërqin (400) Euro, i cili dënim me gjobë do të ekzekutohet pas 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuari nuk e paguan këstin me kohë.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë nga një (1) ditë burgim.

DËNIM ME KUSHT

2. Të pandehurit L Th i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprën tjetër penale.

Në të kundërtën, nëse të akuzuarit brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryejnë veprën tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 par.2 dhe 3 të LPRK-së, do ta revokon dënimin me kusht dhe ndaj personave të dënuar do të shqiptohet dënimi unik për veprën penale të kryer më parë dhe veprën penale të re.

III.OBLIGOHEN të pandehurit L Jdhe L Th që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale secili veç e veç, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj në shumë prej njëzetë (20) euro, dhe në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.Pala e dëmtuar B D me banim në Komuna K , për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Ecuria e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 500/2024, të datës 05.04.2024, kundër të pandehurit L J nga Komuna K rruga " F E , për shkak të veprës penale " Vjedhja ", nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, dhe L Th nga fshati ZKomuna Klinë, për shkak të veprës penale " Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale " nga neni 333 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.11.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala, të pandehurëve L J dhe L Th.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit , gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 242 par.4 të KPPRK-se , të pandehurve i është dhënë mundësia që të deklarojnë për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, Gjykata pasi i kanë udhëzuar të pandehurit për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1 e deri 2.4 të KPPRK-së.

I pandehuri L J deklaron: E pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, , jam i penduar për veprën penale të kryer, i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme, më vjen keq për rastin që ka ndodh, unë palës së dëmtuar B D i kam shkuar në lokal dhe i kam kërkuar falje.

I pandehuri LTh deklaron: E pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, , jam i penduar për veprën penale të kryer, i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme, më vjen keq për rastin që ka ndodh, nuk kam qenë në njohuri që sendet kanë qenë të vjedhura.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurëve deklarohet: se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve L J dhe L Th i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe i njëjti konform dispozitave ligjore të nenit 242 e KPRK-së.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga të akuzuarit L J dhe L Th për veprat penale për të cilën janë ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 par 1 dhe 2 të KPRK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benefitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, është bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurëve është bërë, pasi që të pandehurit e kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: - Deklarata e të dëmtuarit B De dhënë në Stacionin policor në K e datës 23.02.2024; Deklarata e dëshmitarit TB e dhënë në stacionin policor në K e datës 23.02.2024; Deklarata e të pandehurit L Th e dhënë në stacionin policor në K e datës 23.02.2024; Deklarata e të pandehurit L Je dhënë në stacionin policor në K e datës 24.02.2024; Deklarata e dëshmitarit A Ke dhënë në stacionin policor në cilësinë e të dyshuarit në stacionin policor në K e datës 24.02.2024; Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve e datës 23.02.2023; Vërtetim mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht e datës 23.02.2024;

Gjendja faktike e vërtetuar

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurëve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurëve L J qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “ Vjedhja ”, nga neni 313 par. 1 të KPRK-së dhe LTh qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “ Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale “ nga neni 333 par. 2 të KPRK-së.

Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarit e lartëcekur, t'i shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se të njëjtit e kanë kryer veprat penale siq edhe vet i kanë pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtat është përgjegjës. Kjo për faktin se siq e ka pranuar edhe vet, të akuzuarit në ditën kritike për të cilën akuzohen kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e cekura në aktakuzë.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarëve L J dhe L Th, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPRK-së. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprat penale të lartëcekur, është fakti se të akuzuarët e kanë pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, e që kjo rrethanë e cila duke i ndërlidh me rrethanat tjera, si fakt se të njëjtit janë penduar për veprën penale dhe të dëmtuarit ju kanë kërkuar falje, dhe kanë deklaruar se nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme në të ardhmen. Të njëjtit për herë të parë kanë rënë ndesh me ligjin. Ndërsa, gjykata si rrethanë rënduese nuk ka gjetur. Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartëcekura, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurve, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e kanë kryer dhe në këtë mënyrë të njëjtit do të reflektojnë që në të ardhmen mos të shkaktojnë veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës

Konform nenit 449 par. 1 dhe par. 2, nën par. 2.9 dhe nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, gjykata ka obliguar të pandehurit secilin veç e veç në pagesën e taksës në shumë prej 20 (njëzet) euro.

Konform nenit 449 par.1 dhe 2, nënpar.2.6, të KPRK-së, gjykata ka obliguar të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Konform neni 462, gjykata palën e dëmtuar e udhëzon në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Andaj, duke u mbështetur në faktet e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 365 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.64/24 me datë. 13.12.2024

Gjyqtarja Gjykuese:

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.